



VENDIM
Nr.104 Datë 10.12.2010

PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “HEC – VLUSHE” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, date 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.12.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC – VLUSHE” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HEC – VLUSHE” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni finaciari dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) eshte paraqitur dhe plotesuar ne menyre korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për licensimin e shoqërisë “HEC – VLUSHE” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga “Hec – Vlushe”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Bujar NEPRAVISHTA

